



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
(SHOQËROR, GJUHËSOR)**



Prishtinë, qershor 2010

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimi, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

“O, zot, kurr ditën e vet mos e pafshin, që nuk na lanë të jetojmë në shtëpinë tonë, po na i dhanë këto udhë të gjata, që doni kështu të na qitni fare. Dashtë zoti e kurr mos u shtofshi, e mos ngulshi themele në tokën tonë!” fliste nëna dhe sytë i shkëlqenin. Kurrë nuk e kam parë që sytë t’i shkëlqejnë kështu, kurse fytyra t’i kishte marrë atë pamje që sikur digjej flakë. “Doni të na faroni kështu, vetë u farofshi, o zot. Shpëtim gjetshim, ne të pafajshmit, edhe në këtë rrugë. E, një ditë, u kthefshim prapë në këto troje se larg tynë nuk kemi me e pasë jetën tonë të gjatë...”, fliste ajo. Thuajse nuk i kishte mbetur më fije shprese se po i iknim kështu vdekjes se ne po bënim rrugën e shpëtimit... Mezi, duke u dridhur dhe pa trohë fuqie po i bënte hapat e ngathët të atyre këmbëve të dërmuara, që megjithëse ashtu të futura në dhe po e largonin andej edhe pse i dukej që po i shkëputej dhe aty po i mbetej një copë e vetvetes.

(Nazmi Rrahmani: **”Rruga e shtëpisë sime”**)

1. Vendin, si zonë gjuhësore, ku ndodh ngjarja e përshkruar mund ta kuptojmë nga fjalia:
 - A. “larg tynë nuk kemi me e pasë jetën tonë të gjatë”
 - B. Thuajse nuk i kishte mbetur më fije shprese
 - C. Shpëtim gjetshim, ne të pafajshmit, edhe në këtë rrugë
 - D. “që nuk na lanë të jetojmë në shtëpinë tonë”

2. Gjuha e narratorit në këtë fragment është:
 - A. gegërishte
 - B. toskërishte
 - C. standarde
 - D. arbërishte

3. Në fragmentin e mësipërm, nëna flet për:
 - A. shkëlqimin e syve të saj
 - B. lodhjen që i mundonte
 - C. ikjen pa shpresën për t’u kthyer
 - D. ikjen me shpresën për t’u kthyer

4. Folja në fjalinë: *”kurrë mos u shtofshi”*, është në mënyrën:
 - A. habitore
 - B. dëshirore
 - C. dëftore
 - D. urdhërore

5. Në fjalinë: *”pa trohë fuqie po i bënte hapat e ngathët”*, hasim mbiemrin në shkallën:
 - A. pohore
 - B. sipërore
 - C. krahasore të barazisë
 - D. krahasore të ultësisë

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Pse Partia ia boton me një zhurmë shurdhuese këtë roman? Pse mobilizon gjithë kalorësit feudalë të kritikës për t'a trumpeluar si romanin e parë në gjuhën shqipe?... Dhe jo vetëm si romanin e parë, por si një roman të letërsisë shqipe.... Dhe dihet se në Shqipëri janë shkruar edhe më parë, edhe shumë më parë romane... Edhe në gjuhën shqipe!... A është e denjë që të merrej një, parti e tërë nëpërmjet funksionarëve të saj kryesorë me gjëra të tilla?

(Kasëm Trebeshina)

- 6.** Përmes këtij fragmenti autori dëshiron të bëjë me dije se:
- A. partia ka favorizuar një roman të caktuar
 - B. në Shqipëri ishin shkruar edhe romane
 - C. kishte romane në gjuhën shqipe
 - D. partia po falsifikonte faktet letrare
- 7.** Fragmenti ka tipare të:
- A. prozës artistike
 - B. komentit gazetaresk
 - C. letrës së hapur
 - D. shkrimit kritik
- 8.** Në aspektin përmbajtjesor, fragmenti jep të kuptohet se bëhet fjalë për:
- A. rebelim poetik
 - B. mospajtim ideologjik
 - C. rebelim politik
 - D. mospajtim personal
- 9.** Në këtë fragment, mbizotërojnë:
- A. pyetjet retorike
 - B. simbolet
 - C. figurat e fjalës
 - D. krahasimet

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Neni 33

(6) Nëse disa persona fajësohen për disa vepra penale, gjykata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim me kusht që veprat të jenë të ndërlidhura dhe provat të jenë të përbashkëta.

(7) Gjkata mund të vendosë të zbatojë procedurë të bashkuar dhe të marrë një aktgjykim, po qe se para të njëjtës gjykatë zbatohen procedura të ndara kundër të njëjtit person për disa vepra ose kundër disa personave për vepër të njëjtë.

(8) Për bashkim të procedurës vendos gjykata e cila është kompetente për zbatimin e procedurës së përbashkët në bazë të propozimit të prokurorit publik ose sipas detyrës zyrtare.

(Ligji i Procedurës Penale i Kosovës)

- 10.** Fragmenti i mësipërm ka tipare diskursive të shkrimit:
- A. letrar
 - B. gazetaresk
 - C. kodifikues
 - D. eseistik

11. Periudha në paragrafin (7), në bazë të mjeteve lidhëse, është periudhë me marrëdhënie:

- A. lejore
- B. kushtore
- C. shkakore
- D. kundërshtore

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

“Sulmi ishte “thembra e Akilit” e ekipit tonë”, tha mbrëmë në Barcelonë trajneri i kuqekaltërve, pas ndeshjes që ekipi i tij e fitoi me rezultat minimal kundër Interit, duke mos arritur të kalojë në finale. Kronikën që do ta shikoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë.

(Lajm i përshtatur)

12. Në fjalinë: “Kronikën që do ta shikoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë”, e-ja është:

- A. pjesëz
- B. lidhëz
- C. një e përparme
- D. trajtë e shkurtër

13. Nëse faktet do t’i rendisnim duke iu përgjigjur kronologjikisht pyetjeve themelore: “kush, çka, kur ku”, do të kishim fjalinë:

- A. Trajneri i kuqekaltërve mbrëmë në Barcelonë tha se...
- B. Trajneri i kuqekaltërve tha mbrëmë në Barcelonë se...
- C. Mbrëmë në Barcelonë, trajneri i kuqekaltërve tha se...
- D. Mbrëmë, trajneri i kuqekaltërve tha në Barcelonë se...

14. Fjala “thembra e Akilit” e ka kuptimin:

- A. problem i pazgjidhshëm
- B. problem i zgjidhshëm
- C. pika më e dobët
- D. pika më e fortë

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

T’kjosim falë, o i Madhi Zot,
Sa shpejt diellin m’a xû rëja!
Shpejt m’a êndi ‘i pëlhurë t’gjânë e t’gjatë!
E i ká veshun majet rreth e rrotull,
Qi kúr janë kapë trimat tu lumi,
Kaq përzí i ká frima plajm e rê,
Askurnjâ shoshojnë trimat s’p’e njofin

15. Ky fragment është shkëputur nga:

- A. Këngët e Kreshnikëve
- B. Kënga e Rinjohjes
- C. Këngët e Gjergj Elez Alisë
- D. Kënga e Ago Ymer Agës

16. Vargje të tipit: “*T’kjosim falë, o i Madhi Zot!*”, ku kërkohet ndihma e fuqive mbinaryrore, hasen edhe te:

- A. Epi i Gilgameshit
- B. Rubaitë e Khajamit
- C. Odiseja e Homerit
- D. Antigona e Sofokliut

17. Krijimet popullore, pjesë e të cilit është ky fragment, shquhen për:

- A. rimën e rregullt
- B. metrikën e rregullt
- C. mbështetjen në fakte
- D. mbështetjen në histori

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

(Akti fillon me Ismenën, e cila i tregon së motrës për vendimin që ka marrë Kreonti.)

ISMENA

Nga të dy vëllezërit, njërin e nderoi
me varrim Kreonti, kurse tjetrin jo!
Për Eteoklin thonë se dha urdhër,
që në dhë të kallet si e do e drejta,
ligjet e zakonet e qytetit tonë,
me qëllim q'ay të jet' nderuar,
ndër ata që vdiqnë dhe ndodhen te Hadi(3).
kurse për të shkretin Polinik q'i ra
mortja e shkretuar, shpalli në qytet
që asnjë qytetas të mos e varrosë
as të mos vajojë, as të mos qajë,
po mbi dhë ta lenë, si ushqim të ëmbël!
Për zogjtë që gjuajnë të gjejnë ushqim.

18. Nga personazhet dhe struktura e këtij fragmenti kuptojmë se bëhet fjalë për dramën:

- A. Antigona
- B. Prometheu i mbërthyer
- C. Ajaksi
- D. Edipi në kolonë

19. Në vargjet e këtij fragmenti shprehet:

- A. inat
- B. përbuzje
- C. mllef
- D. keqardhje

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Ky autor lindi më 1630 në Gur të Hasit të Prizrenit. Studimet e larta i kreu në kolegjin Ilirian të Loretos dhe në kolegjin e propagandës në Romë. U laureua në teologji dhe filozofi. Filloi punën meshtarë në Pult, kurse në moshën 26 vjeçare u bë ipeshkv i Shkodrës, e më vonë u bë arqipeshkv i Shkupit. Mendohet se këtu përfundoi kryeveprën e vet për të cilën punoi mbi dhjetë vjet (1675 - 1685). Meqë ishte kohë e egër, kur turqit ndiqnin meshtarët dhe dijetarët katolikë shqiptarë, ai e pati të vështirë të ruante dorëshkrimin e veprës së vet në kohën kur, si i përndjekur jetonte në malet e Shqipërisë larg qendrave. Vdiq më 1689 në Prishtinë.

20. Mbështetur në të dhënat e mësipërme biografike që jep ky tekst, për njërin nga autorët e Letërsisë së vjetër shqipe, bëhet fjalë për:

- A. Pjetër Budi
- B. Pjetër Bogdani
- C. Marin Barleti
- D. Frang Bardhi

Në poezinë XVI të veprës “Doktrina e Kërshtenë” të Pjetër Budit, janë vargjet:

Tashti të lus, ndritmë mua,

Zoti im me një rrezë

.....

Sqip të mundënj me rrëfyem

Ndonjë kankë të ré

21. Në këta dy distikë del frymëzimi krijues autorial i lidhur për tre elementë, që janë përcaktues edhe të programit poetik të këtij autori:

- A. lutës, rrëfyës dhe entuziast
- B. tokësor, universal dhe përjetues
- C. fetar, atdhetar dhe individual
- D. qiellor, pajtues dhe vëzhgues

22. Këta dy distikë japin natyrën poetike të poezisë:

- A. elegjiake
- B. përshkruese
- C. satirike
- D. refleksive

23. Cilat nga vargjet e poemës: “Këngët e Milosaos” të Jeronim de Radës, shpreh njërin nga format e paradoksit:

- A. *Fryu era e maleve*
dhe rrëzoi hien e lisit
- B. *Më jep faqen për të puthur*
Më le gërshetin në dorë
- C. *E përveshur e e lartë,*
me gërshet të pleksur
- D. *Luleve që valvit era,*
posi valë që s'kanë mbarim

Jerolim de Rada në veprën “Parime të estetikës”, shkruan:

Kultivimi i bukurisë është kërkesa më e lartë e domosdoshme e çdo veprë arti, që loz një rol të madh në edukimin moral në jetën e njeriut.

- 24.** Arsyeja pse autori ka zgjedhur këto fjalë, është për të treguar:
- A. praninë e të bukurës së lartë
 - B. praninë e të bukurës në vepra
 - C. praninë e të bukurës në jetën e njeriut
 - D. praninë e të bukurës së domosdoshme

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Unë nuk pretendoj të jem e zonja të mësoj diplomatën, gjeografin apo arkeologun. Qëllimi im është shumë më modest. Unë dëshiroj t’i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve në Gadishullin e Ballkanit nga ajo që ai zotëron zakonisht.

Njerëz të këtyre racave të tjera më janë lutur t’i tregoj të gjitha ato që kam parë e dëgjuar, për të kujtuar publikun britanik se, ka edhe popuj të tjerë veç bullgarëve që duhet t’u merren parasysh interesat, dhe për të theksuar që të hollat që jepen nga njerëz bujarë me qëllim, ashtu si mendohet për të ndihmuar Krishterimin, ka të ngjarë që t’i japë shkak Partisë Bullgare që të mendojë se ajo ka mbështetjen e Anglisë dhe për ta inkurajuar atë të shkaktojë dhuna të reja kundër të krishterëve të tjerë.

Kurse njerëz të tjerë më janë lutur që të mos i tregoj ato që kam parë e dëgjuar.

Është e pamundur t’i kënaqësh të gjithë. Mungesa e vendit natyrisht më pengon që të jap hollësitë e këtij udhëtimi tim të gjashtë, në Gadishullin Ballkanik, por jam munduar që të bëj një përshkrim të thjeshtë të fakteve kryesore. Sukseset që munda të arrij, ua detyroj kryesisht miqësisë së atyre që më ndihmuan gjatë udhëtimeve të mia.

Gabimet janë të gjitha të miat.

(Edith Durham: “Brenge e ballkanasve”)

- 25.** Cila fjali e jep më së miri qëllimin e veprës së kësaj autoreje:
- A. Dëshiroj t’i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve
 - B. Njerëz të këtyre racave më janë lutur t’i tregoj të gjitha ato që kam parë e dëgjuar
 - C. Veç bullgarëve që duhet t’u merren parasysh interesat, ka edhe popuj të tjerë
 - D. Sukseset ua detyroj kryesisht miqësisë së atyre që më ndihmuan gjatë udhëtimeve
- 26.** Autorja, në fragmentin e këtij teksti, përqendrohet kryesisht te problemi i:
- A. konfliktit midis popullit bullgar dhe popujve të tjerë
 - B. mbështetjes së Anglisë ndaj interesave të bullgarëve
 - C. paanësisë gjatë paraqitjes së dëshmimeve dhe ngjarjeve
 - D. të hollave që jepen nga njerëz për të ndihmuar Krishterimin
- 27.** Në novelën “E madhe është gjëma e mëkatit” (Tat Tanushi i Bubutimës), përmes fjalisë: “*Rrëfimi nga liqeri i kaltër..., punuar pas dy legjendash të dëgjura në Pogradec*”, Mitrush Kuteli shpall relacionin e:
- A. novelës së tij me dy legjendat
 - B. novelës së tij me liqenin e kaltër
 - C. dy legjendave me liqenin e kaltër
 - D. njëres legjendë me legjendën tjetër

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Enea - Në mitologjinë romake, një princ trojan, i biri i hyjneshës Afërdita dhe i Aniksit. Luajti rol kryesor në mbrojtjen e Trojës kundër grekëve, por kur ra qyteti, u arratis në Kartagjenë. Atje ra në dashuri me Didonën, mbretëreshën vejushë, por e braktisi për të themeluar shtetin e Romës.

- 28.** Ky tekst identifikohet si pjesë e fjalorit:
- A. sinonimik
 - B. të gjuhës letrare
 - C. të fjalëve të huaja
 - D. enciklopedik
- 29.** Cila nga veprat, **nuk** është vepër e autorit të cilit i referohet?
- A. Petro Marko: “Hasta la vista”
 - B. Martin Camaj: “Sheshi i unazës”
 - C. Bilal Xhaferri: “Ra Berati”
 - D. Zejnullah Rrahmani: “Romani për Kosovën”
- 30.** Cila lëvizje letrare në letërsinë shqipe nisi nga fillimi i shekullit XX, duke pasur në plan të parë cilësitë estetike të veprës dhe duke theksuar individualitetin dhe subjektivitetin krijues?
- A. klasicizmi
 - B. realizmi
 - C. modernizmi
 - D. romantizmi

ENGLISH LANGUAGE

- 31.** Dan won the school award for the best essay. The award included a monthly scholarship of £1,358. He was paid _____ last month.
- one thousand, three hundred fifty and eight pounds
 - one thousand and three hundred and fifty-eight pounds
 - one thousand, three hundred, fifty-eight pounds
 - one thousand, three hundred and fifty-eight pounds
- 32.** Lana, Roger, Debbie, and Steven all attend the same school. They spend a lot of time together. They have many things in common. However, this summer they have decided to plan their summer holidays on their own. They will go hitchhiking in Europe.

Look at the table below and choose the correct answer:

	LANA	ROGER	DEBBIE	STEVEN
2nd part of June	Austria	Belgium	Switzerland	France
July	Germany	France	Austria	Belgium
August	France	Germany	France	Switzerland
1st part of September	Switzerland	Austria	France	Germany

- Debbie will stay in France for more than a month.
 - Debbie will visit the same countries as Lana during the summer.
 - All of them will visit Austria during the summer.
 - Roger will start with Belgium and end his trip with France.
- 33.**
- Tom wanted to go to a show.
 - They came by car this morning.
 - It is Saturday afternoon and Susan and Tom are in London.
 - After lunch Susan wanted to do some shopping.
 - They arranged to meet for a meal at 6 o'clock.
- The correct order of sentences to form a dialogue is:**
- 3 2 1 5 4
 - 1 2 3 4 5
 - 3 2 4 1 5
 - 4 5 2 1 2
- 34. ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following sentence. Which one?**
- I don't like this flat! The traffic is very _____ on this road so I find it impossible to concentrate on anything.
- strong
 - heavy
 - loud
 - big

35. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

Peter got up at dawn. He got into his car and started driving. He drove for ten hours before he arrived home. When he got there, he was very tired because _____.

- A. he had been driving all day long
- B. he didn't want to come home
- C. it had dawned.
- D. it had got dark.

36. In the following dialogue:

Sebastian: Roger Wickham will arrive on a 1250 c.c. Honda motorcycle on Sunday and he'll meet the local schoolchildren.

Caroline: I don't believe my ears. Shall we all go and _____ him?
from the following expressions:

- 1. cheer
- 2. jeer
- 3. shout at
- 4. mock

Maggie should say, '**cheer**' because _____.

- A. this is how we show that we do not like someone or his behaviour.
- B. this is how we show our approval and appreciation to someone.
- C. this is what we do when we are angry or annoyed by someone.
- D. this is what we do when we want to make fun of someone.

37. Choose the correct answer to complete the sentence:

I don't think that this house is _____.

- A. Marys'
- B. Marys
- C. Mary's
- D. Marys's

38. The sentence 'He had told him about that earlier.' is in the _____.

- A. Past simple tense
- B. Past perfect tense
- C. Past continuous tense
- D. Past perfect continuous tense

39. Look at the following adjectives. One of them DOES NOT exist. Which one?

- A. harmonious
- B. prosperous
- C. dangerous
- D. furtillious

40. Choose the best way to join the following sentences:

They are not very happy.

They have a big house and successful careers.

- A. They are not very happy even though they have a big house and successful careers.
- B. They are not very happy and so they have a big house and successful careers.
- C. They are not very happy because they have a big house and successful careers.
- D. They are not very happy since they have a big house and successful careers.

41. Choose the correct sentence:

- A. Just to be with you honest, a lot of the jokes Sam us told went my head over.
- B. Just to be honest with you, a lot of the jokes Sam told us went over my head.
- C. Just with you to be honest, the jokes Sam told us a lot of went over my head.
- D. Just honest to be with you, Sam told us a lot of the jokes went over my head.

42. Look at the words in the box:

objection – pictures – to – of - taking – has - headquarters – no – the – she -

The correct combination to form a question is:

- A. She no objection has to taking pictures of the headquarters.
- B. To taking pictures she has no objection of the headquarters.
- C. She has no objection to taking pictures of the headquarters.
- D. She has no objection of the headquarters to taking pictures.

43. Which word is different?

- A. novel
- B. story
- C. biography
- D. poetry

44. Choose the correct word to complete the following sentences:

The teacher didn't join us for a _____.

They had to _____ through the woods.

- A. drink
- B. class
- C. walk
- D. run

45. Which word below does NOT rhyme with the word also?

- A. window
- B. eyebrow
- C. rainbow
- D. follow

46. In the string of words: **horrible, amazing, terrible, discouraging, insignificant**, the word **amazing** is different because _____.

- A. its meaning is positive
- B. its meaning is negative
- C. it is an adverb
- D. it is an adjective

47. Read **the paragraph carefully:**

Western Australia is eight times the size of Britain, but it has only one million people. 900,000 of them live in and around the state capital, Perth. The other 100,000 people live in 'the outback', an area of 2,500,000 square kilometres. The area is hot and dry. Temperatures are usually over 30°C in summer and sometimes 40°C. It hardly ever rains. Sheep farming is the main occupation, and the farms are called 'sheep stations' in Australia. **The children can't go to school, and they hardly ever see a teacher. They have lessons from a two-way radio. It's called 'The School of the Air'. The children can speak to the teacher and other children in the class by radio.**

Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. doesn't think that the children aren't able to go to school and meet the teacher.
- B. thinks that the children don't want to go to school and meet the teacher.
- C. considers that 'The School in the Air' is the only way for children to get **education**.
- D. thinks that 'The School in the Air' is one of the ways for children to get education.

48. The following sign means that _____.


- A. airplanes are dangerous.
- B. airport is near here.
- C. flights are cancelled.
- D. there is no airport around.



49. It is **one** of the most famous sports in the world. It is played indoors and outdoors. All that is necessary is to have a net in the middle of the field and a ball, and, of course, hands. This sport is popular especially among girls.

The sport is called:

- A. basketball
- B. baseball
- C. volleyball
- D. handball



50. Read the following paragraph:

Samantha went to a restaurant for a quick lunch. She looked at the menu and the price list first. Then she ordered a cheese salad which cost £2.50, a chicken sandwich (its price was £3.20). She had an apple juice for £1.20, and she decided to treat herself with an ice-cream that cost £1.50. The waiter brought the bill for _____.

- A. eight pounds and forty pence
- B. seven pounds and forty pence
- C. nine pounds and forty pence
- D. six pounds and forty pence


MATEMATIKË

51. Cila nga barazitë vijuese është e saktë?

- A. $a^3 : a^5 = a^{-2}$
- B. $a^3 : a^5 = a^{3:5}$
- C. $a^3 \cdot a^5 = a^{3 \cdot 5}$
- D. $(a^3)^5 = a^{3+5}$

52. Në një rreth janë dhënë 5 pika të ndryshme. Sa trekëndësha me kulme në ato pika mund të formohen?

- A. 4
- B. 6
- C. 9
- D. 10



53. Cili nga gjykimet e dhëna është i saktë?

- A. p : Ekziston trekëndëshi që ka dy kënde të drejta.
- B. q : Drejtkëndëshi i ka katër boshte të simetrisë.
- C. r : $\frac{a^2 - 9}{a + 3} = a - 3$, $(a \neq -3)$
- D. s : $\frac{5}{7} = \frac{14}{5}$

54. Zgjidhjet e ekuacionit kuadratik $x^2 - 16 = 0$ janë:

- A. $x_1 = -4$, $x_2 = 4$
- B. $x_1 = 0$, $x_2 = 4$
- C. $x_1 = -16$, $x_2 = 16$
- D. $x_1 = 1.6$, $x_2 = -1.6$

55. Cila është zgjidhja e ekuacionit $\sqrt{x-2} = 1$?

- A. $x = 2$
- B. $x = 3$
- C. $x = 5$
- D. $x = 7$

56. Është dhënë funksioni $y = \frac{a}{x}$. Cili funksion do të fitohet nëse pika $P(3, -2)$ i takon grafikut të funksionit të dhënë?

- A. $y = -\frac{2}{x}$
- B. $y = -\frac{4}{x}$
- C. $y = -\frac{6}{x}$
- D. $y = -\frac{8}{x}$

57. Cila është prerja e bashkësive $A = [2, 7]$ dhe $B = [4, 9]$?

- A. $A \cap B = [2, 9]$
- B. $A \cap B = [2, 7]$
- C. $A \cap B = [4, 7]$
- D. $A \cap B = [3, 9]$

58. Janë dhënë funksionet: $f(x) = x^2 - 4$ dhe $g(x) = -\frac{x}{2} - 1$.

Sa është $f(0) + g(-2)$?

- A. 0
- B. -1
- C. -2
- D. -4

59. Sa është 4% e numrit 25?

- A. 1
- B. $\frac{1}{2}$
- C. $\frac{1}{4}$
- D. 4

60. Shuma e tre numrave të njëpasnjëshëm është 120. Cili prej tyre është më i vogli?

- A. 37
- B. 39
- C. 40
- D. 43

61. Janë dhënë këndet $\alpha = 120^\circ - x$ dhe $\beta = 160^\circ - x$. Sa është vlera e këndit x nëse $\alpha + \beta = 140^\circ$?

- A. $x = 65^\circ$
- B. $x = 75^\circ$
- C. $x = 70^\circ$
- D. $x = 80^\circ$

62. Në cilin rast shprehja $12 - 9 : 3 + 3 - [-(-2 \cdot 3 + 1)]$ është njehsuar saktë?

- A. $12 - 9 : 3 + 3 - [-(-2 \cdot 3 + 1)] = 3 : 3 + 3 + 6 - 1 = 1 + 9 - 1 = 9$
- B. $12 - 9 : 3 + 3 - [-(-2 \cdot 3 + 1)] = 12 - 4 + 3 - [-6 - 1] = 12 + 6 = 18$
- C. $12 - 9 : 3 + 3 - [-(-2 \cdot 3 + 1)] = 3 + 3 + [-6 + 1] = 6 + [-5] = 6 - 5 = 1$
- D. $12 - 9 : 3 + 3 - [-(-2 \cdot 3 + 1)] = 12 - 3 + 3 - [6 - 1] = 12 - 5 = 7$

63. Është dhënë shprehja $\sqrt{xy} = \frac{\sqrt{x}}{\sqrt{y}} + \frac{\sqrt{y}}{\sqrt{x}}$, $x > 0, y > 0, y \neq 1$. Sa është vlera e x -it?

- A. $\frac{y}{y-1}$
- B. $\frac{1}{y-1}$
- C. $\frac{y}{y+1}$
- D. $\frac{1}{y+1}$

64. Duke ditur se vlen barazia $x^3 + y^3 = (x+y)(x^2 - xy + y^2)$, tregoni se cila barazi është e saktë:


- A. $x^3 + 8 = (x+2)(x^2 - 8x + 64)$
- B. $x^3 + 8 = (x+2)(x^2 - 2x + 4)$
- C. $x^3 + 8 = (x+8)(x^2 - x + 8)$
- D. $x^3 + 8 = (x+8)(x^2 - 8x + 64)$

65. Ndryshimi i dy numrave është 4, ndërsa ndryshimi i katrorëve të tyre është 64. Cilët janë ata numra?

- A. $x_1 = 11, x_2 = 7$
- B. $x_1 = 12, x_2 = 8$
- C. $x_1 = 10, x_2 = 6$
- D. $x_1 = 9, x_2 = 5$

66. Cili pohim është i saktë për funksionin $y = x^2 + 4x$?


- A. Është rritës në intervalin $x \in (-\infty, +\infty)$.
- B. Ka zerot $x_1 = -4, x_2 = 0$.
- C. Është funksion periodik.
- D. Nuk e pret boshtin Oy.



67. Në një zarf gjendet numri y . Për cilin numër është fjala nëse mesatarja e numrave 2, 7, y është numri 12?

- A. 13
- B. 19
- C. 23
- D. 27

- 68.** Në figurën e dhënë është paraqitur paralelogrami ABCD dhe gjashtëkëndshi i rregullt MNBPDQ te cili vlen $[AM] = [MD]$ dhe $[DQ] = [QC]$. Sa është gjatësia e $[CP]$, nëse dihet se $[DB] = 8 \text{ cm}$?



- A. 2 cm
 B. 3 cm
 C. 4 cm
 D. 5 cm

- 69.** Numri i kundërt i numrit a në lidhje me veprimin e mbledhjes është numri:

- A. $-a$
 B. $\frac{1}{a}$
 C. $-\frac{1}{a}$
 D. $+a$

- 70.** Është dhënë piramida e drejtë katërkëndore, baza e të cilës është drejtkëndësh me brinjët $a = 9 \text{ cm}$, $b = 15 \text{ cm}$, kurse lartësia $H = 12 \text{ cm}$. Sa është vëllimi i piramidës ?

(Vëllimi i piramidës njehsohet me formulën $V = \frac{1}{3} B \cdot H$) ?

- A. $V = 420 \text{ cm}^3$
 B. $V = 480 \text{ cm}^3$
 C. $V = 540 \text{ cm}^3$
 D. $V = 640 \text{ cm}^3$

HISTORI

- 71.** Cili nga dijetarët grek bëri studimin e ngjarjeve historike dhe i vuri bazat e historiografisë antike?
- A. Herodoti
 - B. Aristoteli
 - C. Platoni
 - D. Demokriti
- 72.** Shtetet fqinje ballkanike synonin t'i coptonin trojet shqiptare dhe për këtë qëllim kishin krijuar programe të posaçme politike. Si quhej programi politik shovenist serb që pretendonte pushtimin e tokave shqiptare?
- A. Greqia e Madhe
 - B. Naçertania
 - C. Vorio Epiri
 - D. Megali Idea
- 73.** Ilirët praktikonin besimin politeist që nënkuptonte adhurimin e shumë zotrave. Cilat nga zotrat ishin ilire?
- A. Izida dhe Horusi
 - B. Marsi dhe Neptuni
 - C. Vidasi dhe Bindi
 - D. Dionisi dhe Hera
- 74.** Punëtorët e Parisit në luftë kundër Asamblesë kushtetuese ia dolën ta merrnin drejtimin e kryeqytetit dhe e shpallën Komunën e Parisit si organ i vetëqeverisur. Kur pushoj së funksionuari Komuna e Parisit?
- A. Më 28 maj 1871
 - B. Më 20 maj 1881
 - C. Më 1 prill 1891
 - D. Më 1 shtator 1861
- 75.** Cili ishte kryeministër –kancelar gjerman që ndikoi në bashkimin e Gjermanisë më 1989-1990?
- A. Fransua Miteran
 - B. Erih Honeker
 - C. Angela Merkel
 - D. Helmut Kol
- 76.** Kriza Lindore e viteve 1875-1878 filloi me:
- A. nxitjen e Britanisë së Madhe
 - B. kryengritjen në vilajetin e Kosovës
 - C. kryengritjen në Hercegovinë dhe Bosnje
 - D. nxitjen e Perandorisë Austro-hungareze

- 77.** Cilat janë burimet kryesore historike?
- Burimet materiale, të shkruara dhe gojore
 - Burimet shpirtërore, të miteve dhe legjendave
 - Burimet dokumentare, biblike dhe kuranore
 - Burimet dokumentare, greke dhe romake
- 78.** Cilat territore përfshinte Pashallëku i Shkodrës?
- Territorin e Shqipërisë së poshtme dhe viset e Tesalisë
 - Territorin e Shqipërisë veriore dhe viset deri në Shkup
 - Tokat shqiptare në veri deri në Tivar dhe në jug deri te Butrinti
 - Tokat shqiptare në veri deri në Ulqin dhe në jug deri te Vlora
- 79.** Më 1919 në Shkup u formua Partia Politike Myslimane Shqiptare. Cili ishte programi politik i kësaj partie shqiptare?
- Çlirimi dhe shpallja e Kosovës si shtet i pavarur
 - Çlirimi dhe bashkimi i Kosovës me Mbretërinë Shqiptare
 - Krijimi i federatës së Kosovës në kuadër të Mbretërisë Jugosllave
 - Kërkesa për autonomi të Kosovës si dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe
- 80.** Cilat nga këto ngjarje historike kanë ndodhur sipas rendit kronologjik nga me reja tek tek më e vjetra?
- Beteja e Maratonës, Beteja e Parë e Kosovës, Beteja e Stalingradit
 - Beteja e Maratonës, Beteja e Stalingradit, Beteja e Parë e Kosovës
 - Beteja e Stalingradit, Beteja e Parë e Kosovës, Beteja e Maratonës
 - Beteja e Stalingradit, Beteja e Maratonës , Beteja e Parë e Kosovës,
- 81.** Cilët faktor luajtën rolin kryesor në rënien dhe shkatërrimin e Perandorisë Romake të Perëndimit në vitin 476?
- Kriza e brendshme dhe dyndjet e mëdha të popujve barabar
 - Kriza e jashtme dhe mungesa e forcave ushtarake romake
 - Kriza e jashtme dhe vdekja e Oktavian Augustit
 - Kriza e brendshme dhe luftërat punike
- 82.** Çfarë u detyrua të bënte qeveria shqiptare me rastin e ardhjes së Vilhelm Von Vidit në Shqipëri?
- Të jep dorëheqje dhe pushtetin ta kalonte te Komisioni që udhëhiqej nga Perandoria Osmane
 - Të jep dorëheqje dhe pushtetin ta kalonte te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit
 - Ta dorëzojë pushtetin dhe të bashkëpunonte me Komisionin Gjerman
 - Ta dorëzojë pushtetin dhe të bashkëpunonte me Komisionin Italian

- 83.** Pas përfundimit të Luftës qytetare 1861-1865 SHBA-të u zhvilluan ekonomikisht dhe fituan një stabilitet ekonomik dhe ndikim ndërkombëtar. Cili ishte parimi themelor i politikës amerikane sipas „Doktrinës Monro“?
- A. “Amerika fuqi botërore“që nënkuptonte dominimin amerikan në tërë botën
 - B. “Amerika amerikanëve“që nënkuptonte dominimin e SHBA-ve në tërë kontinentin e Amerikës Veriore
 - C. “Amerika amerikanëve“që nënkuptonte pengimin e çdo ndërhyrje evropiane në kontinentin amerikan
 - D. “Amerika fuqi botërore“që nënkuptonte dominimin amerikan në hapësirën e Oqeanit paqësor
- 84.** Cilat ngjarje ishin vendimtare të cilat bënë që qytetarët në Kosovë sot të jetojnë në demokraci dhe të lirë?
- A. Organizimi i Lëvizjes demokratike gjithë popullore në Kosovë, lufta e UÇK-së dhe intervenimi i NATO-s më 24 mars 1999
 - B. Organizimi i demonstratave gjithë popullore në Kosovë në prill 1999, lufta e UÇK-së dhe intervenimi i NATO-s më 24 maj 1999
 - C. Lufta e UÇK-së dhe intervenimi NATO-s më 24 maj 1999, si dhe rrëzimi nga pushteti i klikës radikale serbe
 - D. Lufta e UÇK-së dhe intervenimi i NATO-s më 24 maj 1999, si dhe rrëzimi nga pushteti i klikës nacionaliste serbe
- 85.** Në Konferencën e Paqes në Paris, në shkurt të vitit 1919,delegacioni shqiptar paraqiti dy memorandume. Cilat ishin kërkesat e palës shqiptare në memorandumun e dytë?
- A. Të pranohet pavarësia e Shqipërisë por duke eliminuar padrejtësitë e Kongresit të Berlinit dhe Konferencës së Londrës
 - B. Të pranohet pavarësia e Shqipërisë duke garantuar të drejtat e shqiptarëve në shtetet ballkanike
 - C. Të pranohen kufijtë e Shqipërisë të vitit 1913 duke siguruar autonomi politike për viset e okupuara shqiptare
 - D. Të pranohen kufijtë e Shqipërisë të vitit 1913 dhe në viset e okupuara shqiptare të vendoseshin forcat e SHBA-ve

GJEOGRAFI

- 86.** Si quhet dukuria e gërryerjes së tokës nën veprimin e forcave të jashtme?
A. Akumulacion
B. Bifurkacion
C. Erozion
D. Erupsion
- 87.** Cili nga lumenjtë e Shqipërisë ka gjatësi më të vogël?
A. Drini
B. Buna
C. Shkumbini
D. Mati
- 88.** Në qoftë se në hartë me shkallë 1 : 600 000, largësia Ferizaj – Gjiilan është 5 cm. Sa është largësia në mes këtyre dy qyteteve?
A. 30 km
B. 45 km
C. 40 km
D. 25 km
- 89.** Cila prej këtyre vijave përdoret për punimin e hartave klimatike për paraqitjen e temperaturave?
A. Izobatet
B. Izohjetet
C. Izohalinet
D. Izotermat
- 90.** Me lëvizjet tektonike vertikale janë krijuar:
A. malet e vjetra - mollake
B. malet e reja – vargmalet
C. mbihypja - shariazhi
D. atiklinaliet - sinklinaliet
- 91.** Numri më i vogël i popullsisë së botës jeton në:
A. hemisferën perëndimore
B. hemisferën veriore
C. hemisferën lindore
D. hemisferën jugore


- 92.** Me rritjen e lartësisë mbidetare temperaturat e ajrit në zbresin në çdo 100m për 0.56°C . Sa do të jetë temperatura në 600 m lartësi nëse në 0 metra lartësi temperatura është 15°C ?
- h = 600 m, temp.= 11.64°C
 - h = 600 m, temp. = 11.62°C
 - h = 600 m, temp. = 9.52°C
 - h = 600 m, temp. = 15.32°C .
- 93.** Hapësira gjeografike e cila shtrihet në të dy anët e lumit Lumbardhi i Prizrenit njihet si:
- rajoni malor i Siriniqit
 - rajoni malor i Sreckës
 - rajoni malor i Shalës së Bajgorës
 - rajoni malor i Kollashinit të Ibërit
- 94.** Pse pjesa më e madhe e Republikës së Kosovës është e mbuluar me tokë të cilësisë së dobët?
- Për shkak të pasurisë bimore
 - Për shkak të klimës së llojlojshme
 - Për shkak të relievit kodrinoro-malor
 - Për shkak të pasurive ujore rrjedhëse
- 95.** Fusha e Moravës shtrihet në:
- verilindje të Fushës së Kosovës, në mes maleve të Gallakut dhe Kopaunikut
 - jugperëndim të Fushës së Kosovës, në mes maleve të Drenicës dhe Zhegovcit
 - veriperëndim të Fushës së Kosovës, në mes maleve të Kopaunikut dhe Rogoznës
 - juglindje të fushës së Kosovës, në mes maleve të Karadakut dhe Zhegovcit
- 96.** Cilat janë malet e vjetra në Europë?
- Uralet, Alpet, Harc, Pirinejet, Peninet, Apeninet dhe Rodopet
 - Vogezet, Karpatet, Shvarcvald, Dinariket, Ardenet dhe Sharrit
 - Rodopet, Vogezet, Shvarcvald, Harc, Ardenet, Peninet dhe Uralet
 - Sharopindet, Masivi qendror, Apeninet, Kastilet, Alpet dhe Iberiket
- 97.** Janë dhënë pohimet:
- Ciklonet krijohen rreth Islandës dhe duke lëvizur në drejtim të Evropës sjellin shi, bor, mjegull dhe erë
 - Ciklonet krijohen rreth Ishujve Azore dhe duke lëvizur në drejtim të Evropës sjellin kohë të ftohtë
 - Ciklonet krijohen mbi Siberi dhe duke lëvizur në drejtim të Evropës sjellin kohë të nxehtë
- Cili pohim është i saktë ?
- Vetëm I
 - Vetëm II
 - Vetëm III
 - I,II dhe III

98. Salanitet më të vogël kanë:

- A. hapësirat ujore që ndodhen në zonën e nxehtë, sidomos në gjerësitë subtropikale
- B. hapësirat ujore që ndodhen në zonën mesatare, sidomos në gjerësitë mesatare
- C. hapësirat ujore që ndodhen në zonën e ftohtë, sidomos në gjerësitë polare
- D. hapësirat ujore që ndodhen në zonën e nxehtë, sidomos në gjerësitë tropike

99. Cili lumë është paraqitur në hartën e dhënë?

- A. Nili
- B. Amazoni
- C. Misisipi
- D. Kongo



100. Tajga është :

- A. bashkësi bimore me bari të ulët në viset e mesme kontinentale
- B. bashkësi bimore e barishtave të larta në viset tropike
- C. bashkësi e pyjeve të larta halore në rajonet e ftohta klimatike të Siberisë dhe Kanadës
- D. bashkësi bimore e myshqeve, likeneve dhe barishtave moçalike në viset polare